

Informacion rreth analizës së tuberkoluzit në kuadër të maternitetit

Tuberkulozi (Tbc-ja) është një sëmundje infektive që shkaktohet nga bakterja e tuberkulozit. Kjo zakonisht shkakton ndezje të mushkërive por edhe pjesët e tjera të trupit mund të goditen. Personat me tuberkuloz të mushkërive mund t'i infektojnë të tjerët duke i kollitur bakteret që shpërndahen përmes ajërit. Nga të gjithë të infektuarit me tuberkuloz sëmuren afërsisht 10 %. Tek të tjerët ky infeksion mbetet, siq quhet latent, dhe ata persona do të mbesin të shëndoshë. Momenti i infektimit mund të ketë qenë para shumë kohësh. Sot ka ilaçe efektive për të shëruar tuberkulozin.

Në shumë pjesë të botës tuberkulozi është sëmundje mjaftë e rëndomtë. Në Suedi sëmuren afërsisht 500 persona nga tuberkulozi dhe shumica e tyre janë emigrantë nga vendet ku tuberkulozi është mjaftë i përhapur. Nëse një femër është e infektuar me tuberkuloz (infeksion latent) dhe është shtatëzënë atëherë ekziston një rrezik i shtuar që ajo të sëmuret në tuberkuloz gjatë gjashtë muajve të parë pas lindjes. Tuberkulozi i mushkërive tek nëna do të thotë rrezik i madh që fëmiju i posalindur të infektohet me tuberkuloz që mund të jetë shumë seriozë dhe i rrezikshëm për fëmijun.

Andaj femrave shtatëzëne të ardhura nga vendet ku tuberkulozi është i përhapur u rekomandohet të bëjnë testin e tuberkulozit gjatë shtatëzënisë. Kjo bëhet përmes analizës së gjakut që mund të bëhet bashkë me analiza tjera gjatë vizitës tek mamia. Analiza tregon se nëse jeni të infektuar më herët nga bakterja e tuberkulozit. Nëse zbulohet se e keni infeksionin e tuberkulozit atëherë ju do të udhëzoheni për tek specialistët në klinikën infektive dhe të mushkërive.